



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

BORDI MBIKQYRËS

**RREGULLORE MBI PROCEDURAT E FINANCIMIT ME GRANT NË
MBËSHTETJE TË SHOQËRISË CIVILE**

(Ndryshuar me Vendimin e BM Nr. 01, datë 19/02/2024)

Në mbështetje të Ligjit Nr. 10093, datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 769, datë 15.07.2009 “Për Miratimin e Statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” (*i ndryshuar*), Bordi Mbikëqyrës:

V E N D O S I :

1. Miratimin e Rregullosës mbi Procedurat e financimit me grante në mbështetje të shoqërisë civile sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e tij.
2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e shumicës së anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës.

KRYETAR I BORDIT MBIKËQYRËS

IRIS LUARASI

SHKURT 2024

RREGULLORE MBI PROCEDURAT E FINANCIMIT ME GRANTE NE MBESHETJE TE SHOQERISE CIVILE

Neni 1

Procedurat e Financimit me grante

Procedurat e financimit me grante për mbështetje të shoqërisë civile realizohet në bazëtë konkurrimit të hapur dhe transparent sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin Nr. 10093, datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”. Ato përcaktojnë mekanizmat përmes të cilave financimi me granteu shpërndahet organizatave të Shoqërisë Civile.

Neni 2

Parimet

Procesi i shqyrtimit dhe përzgjedhjes së subjekteve përfitues (kandidatëve) dhe të financimit me grante për mbështetje të shoqërisë civile, respekton dhe garanton:

- a) lirinë e pjesëmarrjes dhe të konkurrimit;
- b) mosdiskriminimin dhe trajtimin e barabartë;
- c) transparencën e procedurave e të vendimmarrjes, duke u ofruar të gjithë kandidatëve të dhënat dhe procedurën përkatëse;
- ç) përputhshmërinë me objektivat e grandit dhe me efektivitetin e përdorimit të burimeve, në bazë të sistemit të konkurrimit dhe kriterëve, që mundësojnë vlerësimin e projekt-propozimit dhe specifikimeve teknike e financiare për përzgjedhjen e shpërndarjen e grandit;
- d) mungesën e prapaveprimit, duke përjashtuar mundësinë e shpërndarjes së fondeve për veprimtari tashmë të realizuara në datën e vendimmarrjes;
- dh) paanshmërinë e shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe parandalimin e konfliktit të interesave;
- e) përjashtimin e mbivendosjes, që nënkupton shmangien e financimit të së njëjtës veprimtari për të njëjtin interes konkret, më shumë se një herë, gjatë një viti fiskal.
- ë) pavarësinë nga shteti të organizatave jofitimprurëse në përputhje me nenin 6 dhe Nenin 7 te Ligjit Nr. 8788, datë 7 Maj, 2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, (i ndryshuar);
- f) reduktimin e burokracisë në maksimumin e mundshëm, pa cenuar cilësinë dhe transparencën e procesit.

Neni 3

Përcaktimi i prioriteteve afatgjata

1. Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile ka mision themelor nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma civile.
2. Bordi Mbikëqyrës përcakton programin specifik të granteve.
3. Bordi Mbikëqyrës si organ i AMSHC ndërmerri dhe përcakton:
 - a. programe që nxisin e forcojnë qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse, bashkëpunimin ndërsektorial e ndërkombëtar, nismat civile, filantropinë, vullnetarizmin e institucionet demokratike të shoqërisë.
 - b. programe që lehtësojnë përmbushjen e misionit.
4. Bordi Mbikëqyrës përcakton prioritetet afatgjatë në konsultim me aktorë të ndryshëm dhe veçanërisht me shoqërinë civile. Proçesi i përcaktimit të prioriteteve afatgjatë është publik dhe të gjitha palët e interesuara kanë mundësi të bëjnë komente me shkrim. Prioritetet finalizohen në bazë të procedurave të hapura, transparente dhe gjithpërfshirëse.

Neni 4

Programi vjetor i financimeve

1. Brenda muajit janar të çdo viti, Agjencia përgatit një program vjetor “për pjesëmarrjenë procedurë konkurrimi për financim me grante”, që planifikon të organizojë përgjatë 12 muajve. Aplikimet për zbatimin e programit vjetor ndahet në dy faza. Agjencia e shpall këtë program në faqen zyrtare në internet.
2. Faqja zyrtare përmban dokumentet e konkurrimit që lidhen me procedurat e dhënies së granteve, njoftimet e shpallura, pyetjet dhe përgjigjet e lidhura me çdo njoftim/thirrje për aplikim.

Neni 5

Format e grantimit

Agjencia ofron forma të ndryshme të financimit me grante:

- a. **Financim me grante për projekte:** mbështetje për projekte që përfshijnë aktivitete specifike sipas kushteve të shpallura në thirrjen për projektpropozime.
- b. **Financim me grante për mbështetje institucionale:** investime strategjike që u jepen organizatave, zhvillimi i të cilave është i rëndësishëm për:

- Rritjen e qëndrueshmërisë së shoqërisë civile.
- Kontributin në përmirësimin e kapacitetit të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri. Mbështetja jepet duke u bazuar në një proces të hapur dhe konkurrues.

Mbështetja institucionale mund të marre formën e:

- i. granteve afatgjate, për aktivitete specifike,** qëllimi i të cilave është përmirësimi i situatës së përgjithshme të të gjitha Organizatave Jofitimprurëse në Shqipëri (përfshirë përmirësimi i legjislacionit, aplikimi i përqasjeve të reja për ngritje fondesh, aktivitete për ngritje kapacitësh për sektorin, etj.);
 - ii. grante për organizata,** aktiviteti i të cilave është i rëndësishëm për ekzistencën e një shoqërie civile të pavarur përfshirë grupet e të drejtave tenjeriut, organizata vëzhguese/watchdog, etj.
- c. Financim me grante për mbështetje individuale:** mbështetje që u jepet individëve për studime/bursa, pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare dhe të tjera aktivitete të lidhura me zhvillimin e shoqërisë civile, nëse sjellin rezultate në Shqipëri. Grantdhënia për këto qëllime nuk mund të kalojë 3% të buxhetit vjetor në çdo vit fiskal.

Neni 6 Publikimi i konkurrimit

1. Procesi i aplikimit ndjek etapat e përcaktuara në Ligjin Nr. 10093, datë 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për mbështetjen e shoqërisë civile”.
2. Njoftimi për “Thirrje për projekt-propozime”, shpallet në faqen e internetit të AMSHC dhe në median publike.
3. AMSHC shpall në faqen e tij zyrtare udhëzimet për thirrje për propozime, formularin e aplikimit, formularin e buxhetit, kriteret për përzgjedhjen e kandidateve fitues, një listë të plotë të dokumenteve të nevojshëm për t’u paraqitur dhe një kontratë tip. Në faqen zyrtare të AMSHC pasqyrohen, pyetjet sqaruese të bëra nga aplikantët si dhe përgjigjet e dhëna.
4. AMSHC harton udhëzime dhe shpall një listë të qartë për shpenzimet që nuk mbulohen nga financimi me grante.

Neni 7

Kushtet dhe dokumentacioni që shoqërojnë projekt-propozimin

1. Kandidatët, person juridik, që janë regjistruar sipas ligjit dhe kryejnë veprimtari në përputhje me qëllimin e përcaktuar në statutin e tyre kanë të drejtë të aplikojnë, konkurojnë dhe të paraqesin projektpropozimet e tyre.
2. Kandidatët duhet të paraqesin edhe dokumentet e mëposhtme kur aplikojnë për te fituar te drejten e financimit me grante të projektpropozimit të tyre:
 - a. Vendim i gjykatës së rrethit gjyqësor origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin brenda tre mujorit të fundit referuar datës së mbylljes së aplikimeve;
 - b. Shfuqizuar;
 - c. Statutin e organizatës origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin brenda tre mujorit të fundit referuar datës së mbylljes së aplikimeve;
 - d. Shfuqizuar;
 - e. Dokument origjinal që vërteton se kandidati nuk ka detyrime tatimore lëshuar nga organet tatimore;
 - f. Vërtetim për numrin e llogarisë lëshuar nga bankë e nivelit të dytë brenda tre mujorit të fundit referuar datës së mbylljes së aplikimeve;
 - g. Licensë/Leje për ushtrim veprimtarie origjinal ose fotokopje e noterizuar brenda tre mujorit të fundit referuar datës së mbylljes së aplikimeve. Vetëm në rastet kur aktiviteti/ veprimtarite e kërkuara për t'u financuar nuk mund të kryhen, sipas ligjit, pa zotëruar një licensë të akorduar nga autoritetet publike;
 - h. Deklaratë e firmosur dhe vulosur nga personi juridik për autorësinë e projekt-propozimit;
 - i. Prokurë të posaçme në rastet kur aplikanti nuk është i njëjtë me përfaqësuesin ligjor të aplikuesit;
 - j. Dokumentacion i nevojshëm (relacione, referenca) të cilat kërkojnë nga AMSHC apo organet e tij në shqyrtimin e projektpropozimit;
 - k. Bordit Mbikqyrës në çdo rast i lind e drejta referuar natyrës të projekt-propozimit të kërkojë dokumentacion shtesë të paparashikuar më sipër dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi;
3. Nuk mund të konkurrojnë partitë politike, sindikatat, institucionet fetare dhe organizatat politike.
4. Kushtet dhe dokumentacioni që shoqërojnë projekt-propozimin për për financim me grante për mbështetje individuale, përcaktohen me formular të veçantë.

Neni 8

Ndalime dhe përjashtime për financime me grante

1. Agjencia nuk mbështet projekte, të cilat financohen nga linja të tjera të buxhetit të Shtetit dhe që krijojnë mbivendosje.
2. Organizatat të cilat kanë projekt-propozime në proces të mbështetur nga Agjencia, nuk kanë të drejtë të aplikojnë përpara përfundimit dhe paraqitjes së raportit final të këtij projekti.
3. Përjashtohen nga mbështetja për financim me grante projektpropozimet që synojnë:

- a) Përfitime për subjektin përfitues që dalin jashtë objektit të projektit të financuar nga AMSHC;
- b) Mbështetje të partive politike;
- c) Donacione për çështje bamirësie;
- d) Aktivitete fetare;
- e) Mjekim/trajtim shëndetësor apo operacione jashtë vendit.

Neni 9 Procesi i aplikimit

1. Procesi i aplikimit mund të ketë:
 - a. **një fazë**, në të cilën kandidatet paraqesin projekt propozimet;
 - b. **dy faza**, në rastet e projekt-propozimeve afatgjata, ku në fazën e parë ftohen të paraqiten vetëm letrat e interesit të cilat përshkruajnë shkurtimisht projektidenë, dhe me pas, mbi bazën e një vlerësimi paraprak, kandidatet më të mirë ftohen të aplikojnë propozimet e plota.
2. Subjektet aplikuese mund të paraqesin projekt-propozimet e tyre në “Panairin e Ideve” organizuar nga AMSHC. Detajet e organizimit të tij, shpallen në faqen zyrtare të AMSHC-së.

Neni 10 Shtrirja kohore dhe limitet e vlerës së granteve

1. AMSHC ofron:
 - a. **grante afatshkurtra;**
 - b. **grante afatgjata (që kapërcejnë 12 muaj).** Grantet afatgjata u jepen organizatave për projekt-propozime zbatimi i të cilave parashikon një kohëzgjatje deri në **36 muaj**, si për financim me grante për projekte ashtu dhe financim me grante për mbështetje institucionale. Buxheti i projektit ndahet në pjesë, duke mbuluar aktivitete në vitin përkatës fiskal, dhe jepet me këste nga buxheti vjetor i përcaktuar për këtë qëllim;
2. Financimi me grant i ofruar është deri në 5 milion lekë. Për projekt-propozime afatgjata, maksimumi financimit me grant është deri në 10 milion lekë.
3. Shuma e financimit për grante të përcaktuara nga ligji vendoset me vendim të Bordit Mbikëqyrës, në varësi të përjasjes financuese që ai do të preferojë për thirrje specifike.

Neni 11

Kriteret e vlerësimit

1. Vlerësimi mbështetet në përputhjen e projekt- propozimit të paraqitur nga kandidatinë procedurat e konkurrimit për financime me grante me qëllimin e organizatës/kandidat dhe programin që zbaton, kapacitetet e kandidatit aplikues, efektshmërinë e aktiviteteve, pritshmërinë dhe koston e tyre.
2. Projekt-propozimet e paraqitura zbatohen në territorin e Republikës të Shqipërisë.

Neni 12

Afatet kohore të vlerësimit

Për çdo konkurrim, Agjencia ofron një kalendar kohor të procesit të përzgjedhjes, i cili përfshin afatin e fundit për aplikimin e projekt-propozimeve, afatin e fundit për vlerësimin e tyre, datën e pritshme për nënshkrimin e kontratës dhe kohën e pritshme për fillimin e projektit.

Neni 13

Konflikti i interesit

Anëtari i bordit mbikëqyrës ose i çdo organi tjetër të AMSHC-së nuk mund të votojë osetë marrë pjesë në vendim-marrje, kur ai, bashkëshorti ose bashkëshortja, i biri ose e bija, i afërmi, në vijë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me lidhje gjaku ose krushqie, deri në shkallë të dytë, ka interes financiar ose, në çështjet që lidhen me një person juridik, kurai është anëtar, merr pjesë në administrimin e tij ose ka interes financiar në të, sipas ligjit.

Neni 14

Vendim-marrja për financimet

1. Vendim-marrja për financimet me grante realizohet në dy faza të veçanta.

Komisioni i vlerësimit mund të përdorë metodat e mëposhtme të vlerësimit:

- a. Çdo anëtar i komisionit vlerësues shqyrton çdo projekt-propozim dhe jep vlerësimin e tij pas një diskutimi të përbashkët. Në këtë proces mund të ketë një raund të dytë, nëse nga raundi i parë rezultojnë një numër i madh propozimesh të mira.
- b. Çdo anëtar i komisionit shqyrton një numër të kufizuar projekt-propozimesh. Çdo propozim shqyrtohet nga dy vlerësues, anëtarë të komisionit. Vlerësuesit raportojnë përmes një përmbledhje të shkurtuar në komision. Përmbledhja shoqërohet me pikët vlerësuese të sugjeruara, të cilat duhet të jepen me detaje

përkatësisht për çdo kriter. Projekt-propozimi bëhet objekt shqyrtimi ipërbashkët i komisionit.

2. Komisioni i vlerësimit i paraqet Bordit Mbikqyrës projektet-propozimet e prezantuara për konkurrim të cilat plotësojnë listën e dokumenteve për konkurrim. Bordi merr vendimin përkatës për projektet që do të financohen duke konsideruar standardet dhe objektivat.
3. Rezultatet e procesit të vlerësimit mund të shpallen së bashku me pikët e vlerësuara sipas rastit/kërkesës së subjektit.
4. Vendimi i Bordit Mbikqyrës për mosakordimin e grantit argumentohet për secilin kandidat dhe i bëhet të ditur këtij të fundit, pas kërkesës me shkrim të tij.

Neni 15 Kontrata e financimit

Çdo subjekt përfitues nënshkruan një kontratë me AMSHC-në. Kjo kontratë përcakton kushtet e përgjithshme dhe specifike të cilat varen nga lloji i grantit të dhënë (përfshirë këtu sasinë e fondit të marrë, aktivitetet për t'u ndërmarrë, etj.).

Neni 16 Mënyra e financimit dhe bashkëfinancimi

1. Bordi Mbikqyrës vendos nivelin bashkëfinancimit për çdo program, por synimi është t'ju japë një mundësi të gjithë Organizatave Jofitimprurëse të marrin pjesë, përfshirë ato që nuk janë në gjendje të përballojnë bashkëfinancim. Një pjesë, ose i gjithë bashkëfinancimi mund të jetë in kind/në natyrë.
2. Propozimet fituese referuar vendimit të Bordit Mbikqyrës do të marrin 70 % të fondit të miratuar si paradhënie, 20 % pas paraqitjes së raportimit afat-mesëm dhe mbetja prej 10% e fondit të akorduar do të jepet pas miratimit të raportit final; ose do të marrin 50 % të fondit të miratuar si paradhënie, 40 % pas paraqitjes së raportimit afat-mesëm dhe mbetja prej 10% e fondit të akorduar do të jepet pas miratimit të raportit final.
3. Për projekte afat-gjata, këto shifra do të zbatohen për buxhetin vjetor respektiv. Propozimet fituese do të marrin 70% të fondit të miratuar si paradhënie dhe 30% pas paraqitjes dhe miratimit të raportit final; megjithatë Bordi Mbikqyrës, për këto projekte, mund të krijojë një skemë më të mirë operative , e cila do të vlerësohet rast pas rasti në mbledhjet e Bordit Mbikqyrës.

4. Bordi Mbikqyrës rezervon të drejtën e aplikimit të një skeme shpërndarje ndryshe nga pika 2 dhe 3 në rastet kur vlerëson se natyra e projekt-propozimit të miratuar e kërkon dhe justifikon diçka të tillë.
5. Në rastin e mos përmbushjes të aktiviteteve të projektit apo kryerjes së shpenzimeve që nuk kanë qenë të lejuara, pjesa respektive e buxhetit do t'i kthehet autoritetit kontraktues.
6. Për ndryshime mbi 15% në linjat buxhetore, është i nevojshëm një miratim paraprak i autoritetit financues.
7. Përfituesi, për të gjitha të mirat e prodhuara, materiale dhe jo materiale, me fondet e grantit, njihet mbështetjen e marrë nga AMSHC.

Neni 17

Monitorimi i zbatimit të projekteve të financuara

1. AMSHC krijon një departament të veçantë në strukturën e saj, i cili merret me monitorimin e projekteve të financuara. Për çështje specifike, që kërkojnë njohuri të veçanta, AMSHC kontraktton ekspertë të jashtëm. Për projektet me afat më të shkurtër se 1 vit, raportet financiare dhe teknike paraqiten dy herë – në përfundim të gjysmës së parë të projektit (afat-mesëm) dhe në fund të projektit (final). Për projektet që zgjasin më shumë se 1 vit, raportet për vitin e dytë dhe më tej paraqiten çdo 6 muaj.
2. AMSHC raporton periodikisht, jo më rrallë se një herë në gjashtë muaj, para Bordit Mbikëqyrës, lidhur me monitorimin e projekteve të financuara.
3. Në rast mosrespektimi të kushteve të kontratës, AMSHC i rekomandon Bordit Mbikëqyrës marrjen e vendimeve/sanksioneve përkatëse, konform me legjislacionin Shqiptar dhe kontratën tip.

Neni 18

Burimet e Financimit

1. AMSHC siguron burimet e financimit në format e përcaktuara:
 - a. Buxheti i shtetit.
 - b. Nga të ardhura të tjera që i krijon vet, nëpërmjet aplikimit tek thirrje të ndryshme të BE-së, fonde të natyrave të ndryshme që administrohen nga Bashkimi Evropian, si dhe fondet që sigurohen nga negocimet me donatorë të tjerë kombëtarë apo/dhe ndërkombëtarë.
 - c. Çdo dhurim tjetër i ligjshëm, i cili nuk bie ndesh me fushën e veprimtarisë që ligji në fuqi parashikon për AMSHC-në.

Neni 19

Ankimimi

Kandidati brenda **30 ditëve** gëzon të drejtën e ankimimit ndaj vendimit të Bordit Mbikëqyrës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për Bordin Mbikëqyrës
K R Y E T A R I
IRIS LUARASI